

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DURRES

Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 22 23 10 e-mail: info@durres.gov.al

Nr 3224 Prot

Durrës më, 22 / 04 / 2015

KONTRATË PËR SHERBIME KONSULENCE

“Studim projektim rikualifikim i fasadave ne qytet”

Nr. References se Kontrates: BD.SH.K.05.15

Lidhur ndërmjet palëve

Bashkise Durrës “*Autoriteti Kontraktor*”

Dhe

ERALD - G “*Kontraktuesi*”

KONTRATË

“Studim projektim rikualifikim i fasadave ne qytet”

Nr i referencës BD.SH.K.05.15

Kjo marrëveshje (Kontratë) nënshkruhet sot më datë 22.04. 2015, Durrës ndërmjet dy palëve:

“Autoriteti Kontraktor” **Bashkia Durrës**
Adresa : Sheshi “Iliria”, Qyteti Durrës
Tel / fax: 052 22 23 10
NIPT : K42006501R
Përfaqësuar nga Kryetari Bashkise z. Vangjush **DAKO**

Dhe

“Kontraktuesi” **ERALD - G**
Adresa : Diber Maqellare HERBEL, Zyra ne katin e pare, banesa 2-kateshe ne lindje te fshatit herbel, Komuna Maqellare;
Tel /Fax: 0682090392
NIPT : K36306784K
Përfaqësuar nga Administratori z. Gezim **ISLAMI**

Neni 1 - Baza ligjore

Kontrata mbështetet në ligjin nr 9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik”, KPK dhe KVK ne dokumentat e tenderit, ligji nr. 8652 date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore, Vendimin nr. 704, date 29.10.2014 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM” dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2- Përbërja e kontratës

2.1 Kontrata do të përbëhet nga dokumentet e mëposhtëme dhe dokumentat të tjera të tenderit te dates 02.03.2015 , duke përfshirë KPK dhe KVK ne dokumentat e tenderit si dhe aneks kontrata per termat e references, metodologjia e paraqitur nga Kontraktuesi.

- Sigurimi i kontratës në shumën 10 % të vlerës së kontratës në formën e garancisë lëshuar nga shoqëri sigurimi.
- Oferta sipas detyres se projektimit ne dokumentat e tenderit me propozimin teknike dhe ekonomike te paraqitur nga Kontraktuesi ne tender dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktor .

2.2 Fjalët dhe shprehjet në këtë kontratë do të kenë të njëjtin kuptim ashtu siç përcaktohen në Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës ne dokumentat e tenderit.

Neni 3 – Objekti i kontratës

- 3.1 Objekti i kesaj kontrate eshte sherbimi per realizimin e projekt zbatimit te plote per objektin :
“Studim projektim rikualifikim i fasadave ne qytet”

Neni 4 – Çmimi i kontratës

- 4.1 Çmimi që i paguhet kontraktuesit për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të kontratës është
Vlera 2'238'000 leke (dy milion e dyqind e tridhjetë e tete mijë) leke pa tvsh dhe me tvsh
2'685'600 (dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pese mijë e gjashtëqind) lekë
- 4.2 Çmimi perfshin te gjitha detyrimet fiskale qe parashikon legjislacioni shqiptar.

Neni 5 – Afatet e Pagesës

- 5.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 5.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 5.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.
- 5.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita qe janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 5.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitohehen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 6– Afati i dorezimit te projektit

- 6.1 Projekti i zbatimit do te dorezohet nga shoqeria projektuese ne afat kohor prej 30 (tridhjet) ditesh kalendarike nga dita e lidhjes se kontratës sipas kërkesave te kerkuara ne detyren e projektimit(aneks kontrate).
- 6.2 Projekti do te merret ne dorezim nga perfaqesues te Bashkise Durres , te cilet do te verifikojne ate dhe do te leshojne aktin e marrjes ne dorezim te projektit.

Neni 7– Vonesa ne zbatim dhe zgjatja e afatit .

- 7.1 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 8 – Likuidimi i demeve

8.1 Tarifa ditore për demet e likujdueshme per kryerjen e Sherbimeve përtej afatit 30 ditor do të jetë 4/1000 e vleres koresponduese te mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25 perqind e vleres se kontrates.

Neni 9– Te drejtat dhe detyrat e Kontraktuesit

- 9.1 Kontraktuesi do te hartoje projekt zbatimin dhe do ti dorëzohet Autoritetit Kontraktor si parashikohet ne kushtet e kesaj kontrate.
- 9.2 Kontraktuesi eshte i detyruar te marre ne konsiderate dhe te pasqyroje ne projektin e zbatimit te objektit te gjitha verejtjet qe mund te lihen nga organet kompetente ne lidhje me projektin dhe preventivin.
- 9.3 Kontraktuesi nuk ka te drejte te japë projektin per perdorim apo shitje personave te trete pa marre miratimin e Autoritetit Kontraktor, i cili ka te drejten e pronesise mbi projektin e hartuar nga Kontraktuesi.
- 9.4 Kontraktuesi ka te drejte t'i kerkoje Autoritetit Kontraktues pagesen per projektin e hartuar prej tij ne perputhje me nenin 5 te kesaj kontrate.

Neni 10 – Pronesia e projektit

11.1 Çdo gje e dhene ose e paguar per projektin nga Autoriteti Kontraktues , si dhe vete projekti do te jene prone e Autoritetit Kontraktues (Bashkia Durres) si e tille do te konsiderohen kudo qe do te perdoren ato.

Neni 11– Zgjidhja e kontratës

- 12.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse :
- Kontraktori dështon në kryerjen e sherbimit brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes se dhene; ose,
 - Kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër sipas kësaj kontrate.
- 12.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.
- 12.3 Të gjitha materialet, e perfunduara do te behen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata nderpritet për mosplotësim te kushteve te saj.

Neni 12 – Sigurimi i kontratës

- 13.1 Shuma e sigurimit të kontratës prej 10 % të vlerës së kontratës do ti paguhet Autoritetit Kontraktor si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 13.2 Sigurimi i kotratës do ti kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës se dorezimit dhe pranimit te projektit nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 13- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 14.1 Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura në lidhje me këtë kontratë me mirëkuptim dhe negociata midis tyre.
- 14.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do ti drejtohen Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës dhe problemet do të zgjidhen sipas procedurave juridike në fuqi dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë .

Neni 14- Dispozita të fundit

- 15.1 Palet merren vesh midis tyre vetem me shkrim ne adresen e specifikuar ne kontrate . Njoftimi do te kete efekt sapo te dorezohet.
- 15.2 Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e të dy palëve në gjashte kopje, 1 (një) për Kontraktuesin dhe 5 (pese) për Autoritetin Kontraktor.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

AUTORITETI KONTRAKTOR


BASHKIA DURRES


Vangjush **DAKO**
Kryetar i Bashkisë



KONTRAKTUESI

“ERALD - G”


Gezim ISLAMI
Administrator i shoqërisë



ANEKS- KONTRATE

“Studim projektim rikualifikim i fasadave ne qytet”

Nr. References se Kontrates: BD.SHLK.05.15

TERMAT E REFERENCES

DETYRE PROJEKTIMI

TREGUESI

1. Objekti i ndërhyrjes për rikualifikimin e fasadave ne qytet
2. Lista e dokumentacionit të vënë në përdorim të konsulentit në dispozicion nga Bashkia e Durrësit
3. Lista e dokumentacionit që duhet paraqitur

1. OBJEKTI I NDERHYRJES

Në kuadër të Investimeve të miratuara ne Buxhetin e vitit 2015 Bashkia Durrës kërkon realizimin e projektit për *“Studim projektim rikualifikimi fasadave ne qytet”*

Objekti i këtij projekti është rikualifikimi i fasadave ekzistuese te godinave ne qytet, sic tregohet dhe në fig.1



Fig. 1 AKSET E NDERHYRJES SE STUDIMIT

Shtresezimi kaotik I rritur dukshem pas viteve 90, pakujdesia e trajtimit te godinave, rruget te gjitha te

njejta, percpetohen sot si nje aglomerat homogjen ne shkallen kromatike te godinave e rrugeve, me theks ne nderhyrje te guximshme qe bien shume ne sy.

Ne vitet e fundit jane bere shume nderhyrje ne hapësiren publike dhe keto operacione po e rforcojne qendren. Ky projekt vjen si nevoje e ketij viti, pas nderhyrjes se meparshme te vitit 2014 ne Bulevardin Dyrrah e Bulevardin Epidamn.

Nje nderhyrje e perqendruar ne godina mund te qartesoje zona te caktuara te qytetit, ti vleresoje ato, te vendose nje hierarki te hapësirave e rrugeve, mund te nxjerre ne pah karakteristika te “zonave” te caktuara si dhe seciles prej rrugeve.

Rishikimi sot i thurjes urbane, na ka ndihmuar te kuptojme qe ekziston nje trashgimi arkitektonike interesante e bere “opake” nga nje membrane e cila ka vendosur cdo nje ne te njejtin plan. Eshte nje trashgimi e lindur rreth viteve ‘20 te shekullit te kaluar, e perbere nga ndertime rezidenciale modeste por te ekuilibruara si dhe nga godina te tjera me te rendesishme vepra te arkitekteve italiane (si psh. Gjykata e Shkalles se Pare; Teatri “A.Moisiu”); e vazhduar me pas me godina me te moderuara te viteve ‘30, me kolona e harqe, te kuruara ne gjuhe dhe teksture arkitektonike. Per vleresuar keto objekte dhe vazhdimesine e tyre qe ndodhen ne akset e percaktuara ne detyren e projektimit, nevojitet hartimi i nje projekti te mirefillte per rikonstrukcionin e ketyre fasadave.

Rekomandohet qe projektuesi te mbaje ne konsiderate edhe raportin e Masterplanit te Qendres se Durrësit, i cili trajton temen e ruajtjes se fasadave.

Akset qe do te meren ne studim nga projekti jane te caktuara ne figuren 1, per me teper objektet shtrihen ne te dy anet e rruges:

1. “Aleksander Goga”; deri ne kryqezimin me:
2. Rruga e “Deshmoreve”
3. Rruga “Adria” deri tek sheshi “Selaniku” (ne kryqezim me rrugen “J.Ballhysa”)
4. Objektet tek Sheshi “26 Nentori 1912” (St.Trenit)
5. Rruga “Egnatia” deri tek hyrja e portit
6. Rruga “Hafiz Podgorica”
7. Rruga “Kristaq Rama”

Projekti i rikualifikimit të fasadave ne qytet ka per qellim keto tematika:

- Nxjerrjen ne pah te vlerave arkitektonike te objekteve te rendesishme
- Propozim per rikonstrukcion teknik i fasadave ne suvatim sipas nje vleresimi te detajuar ne terren.
- Ruajtjen e vleresimin e objekteve pjese e trashegimise kulturore (nese ka) ose institucioneve te vecanta si Gjykata e Rrethit, Pallati Kultures, ish Fabrika e Miellit, etj
- Rekomandohet trajtimi ne menyre te vecante dhe me impakt neutral ne godinat ne afersi te qendrave arkeologjike
- Rekomandohet trajtimi i bazamentit te godinave dhe kornizimi i siperm i unifikuuar ne ngjyre, kryesisht ne objektet me lartesi te perafert e te shtrira ne nje linje.
- Projekti duhet te jape zgjidhje per instalimet teknike qe sot gjenden te pozicionuara ne situatë kaotike ne fasada, kullimin e ujrave te shiut, instalimet e internetit, tv, etj.

2. LISTA E DOKUMENTAVE NË PËRDORIM TË KONSULENTIT VËNË NË DISPOZICION NGA BASHKIA E DURRËSIT

- Fotomontazhe te akseve nga te dy anet e rrugeve;

- Ortofoto;
- Harta file .dwg te Aluiznit 2007;

3. LISTA E PROJEKTEVE QE DUHEN PARAQITUR

- 4.1 Relacioni i pergjithshëm i projektit. *Format A4*
- 4.2 Projekti arkitektonik: *Format A2, A1, A0*
- Planimetri
 - Pamje te gjendjes ekzistuese
 - Pamje te propozuara të projektit
 - Fotomontazhe.
 - Detaje Arkitektonike
 - Detaje Zbatimi
 - Relacionet dhe specififikimet përkatëse

Shenim Teknik : Te gjitha Vizatimet Arkitektonike te jene ne shkallen 1:100; 1:200; 1:500

4.3 Preventivi i punimeve dhe analiza e tyre, sipas manualit te çmimeve ne fuqi te miratuar nga Ministria, i shoqeruar me specififikimet teknike perkatëse.

Format A4

4.4 Grafiku i punimeve

4.5 Vlerësim të ndikimit në mjedis

- Projekti do te hartohet dhe paraqitet ne 5 kopje, te printuara sipas formateve te specifikuara me siper dhe informacioni tërësisht i dixhitalizuar (.dwg + .pdf) ne 5 kopje (CD apo DVD)
- Kopja elektronike e projektit eshte pjese perberese e dokumentacionit teknik te dorezuar.
- Dorezimi do te behet prane Bashkise Durrës
- Depozitimi i tij do te behet prane Sekretarise Teknike te Departamentit te Urbanistikes te Bashkise Durrës.

Bashkangjitur: Metodologjia 18 faqe, oferta ekonomike+e detajuar 2 faqe.

AUTORITETI KONTRAKTOR

Bashkia Durrës

Vangjush DAKO
Kryetar i Bashkise



KONTRAKTUESI

“ERALD - G”

Gezim Islami

Gezim ISLAMI
Administrator i shoqërisë



M E T O D O L O G J I A

**OBJEKTI: STUDIM PROJEKTIM RIKUALIFIKIM
I FASADAVE NË QYTET**

NË BASHKINË DURRES



“ERALD-G” Shpk

MARS' 2015



1. PËRSHKRIMI I BASHKISË SË DURRËSIT

1.1 Pozicioni Gjeografik

Rrethi i Durresit ndodhet ndermjet 41 e 36' deri 41 e 15' gjeresi gjeografike veriore dhe 19 e 15' deri 19 e 38' gjeresi gjeografike lindore. Ai shtrihet nga kepi I Rodonit ne veriperendim deri tek Prroi I Agait pas shkembit te Kavajes ne jugperendim me nje siperfaqe 430km² dhe me nje lartesi mesatare mbi nivelin e detit 2-6 metra. Vete qyteti I Durresit ze pjesen perendimore te rrethit te Durresit midis koordinatave 41 e 18' e 40 " gjeresi gjeografike veriore deri ne 19 e 26' e 21" gjatesi gjeografike lindore me siperfaqe 1,626 ha. Gjatesia e pergjithshme e vijes kufitare eshte 121.3km. Nga keta 52.4 jane kufij tokesore , 61.8 kufij detare , 7.1 jane kufij lumore. Ne pjesen perendimore Durresi laget nge deti Adriatik, duke pasur nj vije bregdetare te thyer. Kufijte tokesore jane me rrethin e Tiranës dhe Krujes ne lindje dhe verilindje dhe me rrethin e Kavajes ne jug dhe juglindje. Durresi ka pozi te faorshme gjeografike. Durresi ndodhet ne kryqezimin e rrugeve te medha tregtare. Nder rruget kryesore jane: Durres-Oher-Manastir-Sofje-Stamboll; Durres-Elbasan-Korce-Follorine-Selanik. Durresi ka rendesi e madhe strategjike.

NDERTIMI GJEOLOGJIK

Durresi ben pjes ne ultesiren praneadriatike, qe shtrihet nga Lezha deri ne Vlore. Zhvillimi gjeologjik i territorit te Durresit i perket Plioceni dhe Kuaternarit kur ultesira praneadriatike nisi te dale mbi uje si pjese e kontinentit. Deti u terhoq perfundimisht. Gjate kesaj periudhe ne Kuaternar kane ndodhur shume procese qe kane cuar ne formimin e strukturave antiklinale dh sinklinale. Territori i Durresit perbehet gjithashtu nga depozitime terrigjene (ranore, konglomerate, argjile, gelqeroresh etj. Ne territorin e Durresit ka dhe prurje aluvionale. Ne ndertimin e relievit te Durresit kane ndikuar edhe termetet. Pasoje e ketij ndertimi gjeologjik jane edhe pasurite ne- tokesore si qymyrguri etj.

KLIMA

NE formimin e klimes ndikojne nje sere faktoresh sic jane faktoret planetare (kozmiqe) dhe ato lokale. Durresi ka nje klime mesdhetare. Faktoret lokale jane te lidhur me relievin. Faktori me aktiv ne klimen e Durresit eshte ndikimi i detit nepermjet te cilit behet i mundur qarkullimi i masave ajrore te Atlantikut dhe te Mesdheut. Ne faktoret lokale ben pjese edhe veprimtaria e njeriut, qe ne durres eshte shprehur me nderhyrjet ne kushtet natyrore. Ku vecojme tharjen e keneses, c'pyllezim ne

zonat kodrinore. Per t'i kthyer ne toka bujqesore, ndertimi i ujembledhezve apo ngritja e objekteve industriale.

Elementet e klimes


a) Temperatura e ajrit

b) Diellrimi

c) Reshjet

ERERAT

Jane nje element me rendesi te madhe gjeografike dhe agrometeorologjike per ultesiren perendimore. Ererat karakteristike per Durresin jane brizat. Gjate veres ne Durres ka rreth 71 dite me briza, kurse ne dimet 18 dite. Numri mesatar vjetor eshte 191 dite. Ne perputhje me motin briza fillon nga ora 9-10 paradite dhe vazhdon deri ne 16-18 pas dite. Shpejtesia mesatare e saj ne mesdite eshte 4-6 m/s. Era qe ndihet ne Durres jane Murrai, Shiroku, dhe Juga. Element tjetër i klimes eshte vranesira, qe ne Durres ka mesatare veriore 4.7 balle. Numri mesatar i diteve te vraneta eshte 89.9 dite/vit ndersa dite te kthjellta eshte 110.6 dite ne vit.



1.2 DURRESI SOT

Në rrethin e Durrësit janë aktualisht në aktivitet 3511 subjekte ekonomikë, midis të cilave 64 shoqëri të përbashkëta (Filanto, Floryhen, Triumph, eurotech), etj që merren më rieksporin e konfeksioneve të këpucëve, peshkut etj. Në Durrës operojnë aktualisht 9 banka, pjesa më e madhe e të cilave janë të huaja.

Porti i Durrësit, është një nga portet më të vjetra të Evropës në detin Adriatik dhe një nga kryeurat ballkanikë të komunikimit të perëndimit më lindjen dhe anasjelltas. Ai është përcaktuar si një pikë hyrje për Korridorin e 8 të transportit që fillon nga Shqipëria, kalon nëpërmjet Maqedonisë dhe Bullgarisë për të mbërritur në portin e Varnas dhe Burgasit në Detin e Zi. Objektivi kryesor i projektit është krijimi i një transporti të sigurt, sipas standardëve të projektimit evropian dhe ndërkombëtarë.

Ojithashtu është porti më i madh i vendit, i cili mbulon rreth 85 % të import-eksporteve shqiptarë të mallrave dhe më i rëndësishëm në transportin detar të udhëtarëve.

Porti i Durrësit ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 1,4 km² dhe një akuatorium prej 0,67 km². Kanali i hyrjes është 9,5 m i thellë, 40 m i gjerë dhe 1,2 milje i gjatë. Në port funksionojnë 11 kalata operues nga 6,6-11 m të thella më një gjatësi rreth 2.200 m. Sipërfaqja totale për depozitimin e mallrave është 270.000 m² nga të cilat 27.000 m² janë të mbuluara.

Në portin e Durrësit ngarkohen dhe shkarkohen të gjitha llojet e mallrave mineralë, karburante, cemento dhe artikuj të kategorive të ndryshme.

Në port gjendët dhe terminali i trageteve, i cili ka në dispozicion një kalatë më gjatësi 186 m dhe zhytje që varion nga 7,40-7,90 m. Në këtë terminal, gjatë vitit 2002, u përpunuan 1.683 tragete më 600.500 pasagjerë, 138.000 automjete dhe 368.000 ton mallra.

Terminali i konteniereve është në fazën ndërtimore. Përveç kalates dhe sheshit që ka në dispozicion, në ndihmë të terminalit të konteniereve në portin e Durrësit ndodhen edhe një sërë pajisjesh që ndihmojnë në ngarkim-shkarkimin e tyre.

Aktualisht në portin e Durrësit janë futur në përdorim fondet e Bankës Botërore prej 23 milion USD, Programi PHARE më 11 milion USD, TDA me 1,9 milion USD investime këto që kanë si destinacion rehabilitimin e kalatave, shtrimin e shesheve, blerjen e elektronikave dhe makinerive për përpunimin e konteniereve etj. Porti i Durrësit ka përfituar gjithashtu një kredi prej 17 milion euro nga Banka evropiane e Zhvillimit. Projekti përfshin ndërtimin e terminalit të ri të trageteve dhe rikonstruksionin e tij ekzistues. 90 % e vëllimit të transportit detar në Shqipëri kryhet nëpërmjet Portit të Durrësit dhe kapaciteti vjetor i përpunimit të mallrave është rreth 3 milion ton. Më krijimin e zonës fiskalë, kapaciteti i Portit do të arrijë në 5 milion ton mallra të përpunuara në vit.

Në port funksionojnë rreth 75 agjenci detare spedicionere, nga të cilat 6 agjenci detare që trajtojnë 14 tragete udhëtarësh dhe automjetesh. Më e madhja është agjencia publike "Taulantja sh.a". Aktualisht, në portin e

Durrësit është dyfishuar numri i trageteve krahasuar më një vit më parë. Çdo javë në këtë port akostohen rreth 40 tragete dhe katamarane që lidhin Durrësin më portet e tjera të Mesdheut.

Durrësi është një e të gjitha llojeve të transportit. Nëse do t'i referohemi shprehjes së vjetër që në kohën e Perandorisë Romakë së "Të gjithë rrugët të çojnë në Romë", në Shqipëri, do të ishte: "Të gjithë rrugët të çojnë në Durrës".

Durrësi, qytet 3000-vjeçar në zëmër të Evropës. Në qendër të tij ndodhet Amfiteatri më 20.000 vende, unik në të gjithë Ballkanin.

Trashëgimia arkeologjike e qytetit e bën të natyrshme që çdo durrsak të ndjehet krenar për qytetin e tij. Durrësi i cilësuar si Taverna e Adriatikut, mirëpret në kohët modernë, turist dhe vizitor nga e gjithë bota. Tashmë Durrësi është përfshirë në projekte të fuqishme të Bankës Botërore dhe Agjensivë të rëndësishme Ndërkombëtare. Ai ka hyrë në një fazë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik lokal. Turizmi dhe vlerat arkeologjike, presin çdo turist dhe vizitor për të shijuar bukuritë natyrore dhe për të prekur dhe parë nga afër lashtësinë.



Zhvillimi ekonomik dhe interesi i madh për të sjellë në Durrës eksperiencat më të mira të vendeve të zhvilluara, i ofrojnë investitorëve dhe biznesmenëve mundësi dhe terren për të arritur sukses në aktivitetet e tyre. Mjedisi shumë i favorshëm, mundëson krijimin e zonave industrialë, krijimin e plazheve elitare në zona të virgjëra, studime e master planë, zbulime arkeologjike, ndërtime të rrugëve të reja dhe përmirësimin e infrastrukturës. Politikat ekonomike financiare lokale, lehtësojnë investitorët në sipërmarrjet e tyre.

Nisur nga këto :


Vizioni i strategjisë së Bashkisë për zhvillimin e qytetit të Durrësit është : "Një kryesorë e vendit për transportin detar, rrugor, hekurudhor, zona më e rëndësishme e vendit në fushën e turizmit masiv dhe atë elitare, që ofron histori dhe arkeologji unike, qendër kryesorë për tregtinë më jashtë dhe industrinë eksportuese, qytet i bankave dhe i shoqërive të sigurimit, më një komunitet që gëzon një cilësi jetë të avancuar".

2. GJENDJA EGZISTUESE E FASADAVE


1 "ALEKSANDER GOGA"; DERI NE KRYQEZIMIN ME



2. RRUGA E "DESHMOREVE"



3. RRUGA "ADRIA" DERI TEK SHESHI "SELANIKU" (NE KRYQEZIM ME RRUGEN "J.BALLHYSA")






4. OBJEKTET TEK SHESHI "26 NENTORI 1912" (ST.TRENIT)



A handwritten signature in blue ink, located at the bottom left of the page.

A handwritten signature in blue ink, located at the bottom right of the page.

5. RRUGA "EGNATIA" DERI TEK HYRJA E PORTIT




[Handwritten signature]


-16-

[Handwritten signature]

6. RRUGA "HAFIZ PODGORICA"




7. RRUGA "KRISTAQ RAMA"



3. VLERESIMI I PROJEKTIT

- Në kuadër të Investimeve të miratuara në Buxhetin e vitit 2015 Bashkia Durrës kërkon realizimin e projektit për **“Studim projektim rrikualifikimi fasadave në qytet”**.
- Objekti i këtij projekti është rrikualifikimi i fasadave egzistuese të godinave në qytet, siç tregohet dhe në figuren e mëposhtme.



AKSET E NDERHYRJES SE STUDIMIT

Mhtresezimi kaotik i rritur dukshëm pas viteve 90, pakujdesia e trajtimit të godinave, rruget të gjitha të njëjta, perceptohen sot si një aglomerat homogjen në shkallën kromatike të godinave e rrugëve, me theks në nderhyrje të guximshme që bien shumë në sy.

Në vitet e fundit janë bërë shumë nderhyrje në hapësirën publike dhe këto operacione po e rforcojnë qendrën. Ky projekt vjen si nevojë e këtij viti, pas

nderhyrjes se meparshme te vitit 2014 ne Bulevardin Dyrrah e Bulevardin Epidamn.

Nje nderhyrje e perqendruar ne godina mund te qartesoje zona te caktuara te qytetit, ti vleresoje ato, te vendose nje hierarki te hapësirave e rrugeve, mund te nxjerre ne pah karakteristika te "zonave" te caktuara si dhe seciles prej rrugeve.

Rihikimi sot i thurjes urbane, na ka ndihmuar te kuptojme qe ekziston nje trashgimi arkitektonike interesante e bere "opake" nga nje membrane e cila ka vendosur cdo nje ne te njejtin plan. Eshte nje trashgimi e lindur rreth viteve '20 te shekullit te kaluar, e perbere nga ndertime rezidenciale modeste por te ekuilibruara si dhe nga godina te tjera me te rendesishme vepra te arkitekteve italiane (si psh. Gjykata e Shkalles se Pare; Teatri "A.Moisiu"); e vazhduar me pas me godina me te moderuara te viteve '30, me kolona e harrq, te kuruara ne gjuhe dhe teksture arkitektonike. Per vleresuar keto objekte dhe vazhdimesine e tyre qe ndodhen ne akset e percaktuara ne detyren e projektimit, nevojitet hartimi i nje projekti te mirefillte per rikonstrukcionin e ketyre fasadave.

Rekomandohet qe projektuesi te mbaje ne konsiderate edhe raportin e Masterplanit te Qendres se Durrës, i cili trajton temen e ruajtjes se fasadave.

Akset qe do te meren ne studim nga projekti jane te caktuara ne figuren e meelperme, per me teper objektet shtrihen ne te dy anet e rruges:

6. "Aleksander Goga"; deri ne kryqezimin me:
7. Rruga e "Deshmoreve"
8. Rruga "Adria" deri tek sheshi "Selaniku" (ne kryqezim me rrugen "J.Balhysa")
9. Objektet tek Sheshi "26 Nentori 1912" (Stacioni Trenit)
10. Rruga "Egnatia" deri tek hyrja e portit
11. Rruga "Hafiz Podgorica"
12. Rruga "Kristaq Rama"

Projekti i rikualifikimit të fasadave ne qytet ka per qellim keto tematika:

- Nxjerrjen ne pah te vlerave arkitektonike te objekteve te rendesishme.
- Propozim per rikonstrukcion teknik i fasadave ne suvatim sipas nje vleresimi te detajuar ne terren.

- Ruajtjen e vleresimin e objekteve pjese e trashegimise kulturore (nese ka) ose institucioneve te vecanta si Gjykata e Rrethit, Pallati Kultures, ish Fabrika e Miellit, etj.
- Rekomandohet trajtimi ne menyre te vecante dhe me impakt neutral ne godinat ne afersi te qendrave arkeologjike.
- Rekomandohet trajtimi i bazamentit te godinave dhe kornizimi i niperme i unifikuar ne ngjyre, kryesisht ne objektet me lartesi te prafert e te shtrira ne nje linje.
- Projekti duhet te jape zgjidhje per instalimet teknike qe sot gjenden te pozicionuara ne situat kaotike ne fasada, kullimin e ujrave te shiut, instalimet e internetit, tv, etj.



4. VLERËSIMI I NDIKIMIT MJEDISOR

Mjedisi me të gjithë komponentët e tij është një nga elementët më të rëndësishëm ku fokusohet dhe analiza e thelluar si dhe vizioni e strategjia e zhvillimit. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis kërkon që formulimet politike, projekt planet dhe program-propozimet të përfshijnë konsideratat mjedisore në zhvillimin e politikave publike.

Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përmbledhet më poshtë. Metodologjia është në linjë me Direktivën Europiane të VNM, projekt-ligjin mbështetës për VNM dhe udhëzimet ndërkombëtare.

A) Konteksti, objektivat dhe baza

- Identifikimi i planeve të tjera, programeve dhe objektivave për mbrojtjen e mjedisit
- Mbledhja e informacioneve të tjera bazë
- Identifikimi i problemeve mjedisore
- Zhvillimi i objektivave të VNM
- Konsultimi mbi "Qellimin" e VNM

(B) Zhvillimi dhe përpunimi i alternativave dhe vlerësimi i ndikimeve

- Testimi i objektivave të Projektit kundrejt objektivave të VNM
- Hartimi i alternativave strategjike
- Reduktimi i ndikimeve negative (përfshirë përmirësimet)
- Hartimi i masave monitoruese

(C) Përgatitja e Raportit Mjedisor

(D) Konsultimi mbi projektin dhe Raportin Mjedisor

- Konsultimi me Agjencitë dhe publikun
- Vlerësimi i ndryshimeve të duhura domethënëse
- Vendimmarrja dhe dhënia e informacionit


(E) Monitorimi dhe zbatimi

Para e parë trajton analizën e gjendjes ekzistuese dhe synon kufizimin e efekteve negative që ekzistojnë në territor. Vlerësimi i ndikimit në mjedis do të jetë plotësisht i integruar me të gjitha opsionet dhe në të njëjtin nivel me konsiderimin e analizës ekonomike apo sociale të zhvillimit të planit vendor. Rezultatet e pritshme të vlerësimit strategjik mjedisor synojnë identifikimin e llojit dhe shtrirjes së efekteve negative mjedisore si dhe prezantimin e mjeteve apo rrugëve për shmangien, kufizimin apo eliminimin e tyre.

Rëndësi e veçantë i kushtohet përpunimit të mbetjeve urbane, trajtimit të ujërave të zeza, impaktit të akteve të rëndësishme rrugore etj.

Si rezultat i fazës së parë të Vlerësimit Mjedisor, hartohet Harta e kufizimeve/rezervimeve me rekomandimet përkatëse për zhvillimet në territor.

Nga ana tjetër VNM në fazën e dytë ofron një vlerësim të qëndrueshmërisë mjedisore të Planit të propozuar. Në mënyrë të posaçme, VNM identifikon çdo efekt mjedisor negativ që mund të ketë plani vendor dhe sugjeron masat për zbuljen e tyre. VNM hartohet bazuar në vlerësimin tërësor të situatës mjedisore ekzistuese, duke përfshirë këtu edhe rregullimet e politikave, ato menaxheriale dhe institucionale në lidhje me mbrojtjen mjedisit. Përfshirja e aktoreve/grupeve të interesit është e rëndësishme në procesin e hartimit të VNM, në këto aktorë rol të rëndësishëm do të luajnë dhe Agjencia Rajonale Mjedisore dhe Ministria e Mjedisit, si autoriteti miratues i VNM-së. Procesi që do të përdoret për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet potenciale të Planit mund të konsiderohet sipas fazave konceptuale të treguara në vijim.



Rezultatet dhe rekomandimet e VNM do të paraqiten në raport duke përfshirë dhe elementët e monitorimit të mjedisit që do të kihen parasysh gjatë implementimit të projektit.



15

5. PLANI I PUNES DHE ORGANIZIMI

Ne vijim është pasqyruar nje plan pune që konsiston ne afatet e aktiviteteve kryesore dhe ne angazhimin e stafit. Ne hartimin e planit te punes konsulentit i eshte permbajtur detyrimeve te ligjit, kerkesave te termave te references dhe metodologjise qe do te perdoret. Periudha e propozuar per realizimin e projektit shtrihet ne **30** dite pune nga nënshkrimi i kontrates.

GRAFIKU I KRYERJES SE PUNES PER HARTIMIN E PROJEKTIT

OBJEKTI : STUDIM PROJEKTIM RIKUALIFIKIM I FASADAVE NË QYTET, BASHKIA DURRËS

Nr.	Programi i Punes Ndarja ne Muaj Aktivitetet Kryesore te Sherbimit	Koha e Hartimit te Studimit (1 Muaj)					
		Muaji 1					
		5	10	15	20	25	30
Administrimi dhe menaxhimi i projektit							
LISTA E PROJEKTEVE QE DUHEN PARAQITUR							
1.1	Relacioni i pergjithshëm i projektit						
	Projekti arkitektonik						
	Planimetri						
	Pamje te gjendjes ekzistuese						
1.2	Pamje te propozuara të projektit						
	Fotomontazhe						
	Detaje Arkitektonike						
	Detaje Zbatimi						
	Relacionet dhe specifikimet perkatese						
1.3	Preventivi i punimeve						
1.4	Grafiku i punimeve						
1.5	Vlerësim të ndikimit në mjedis						
STAFI I PROJEKTIT							
1	Drejtuesi i Projektit / Arkitekt	30					
		dite					
2	Inxhinier Urbanist / Arkitekt	30					
		dite					
3	Inxhinier Ndertimi	30					
		dite					
4	Inxhinier topograf	30					
		dite					
5	Inxhinier Elektrik	30					
		dite					
6	Eksperti i Mjedisit / me çertifikate	30					
		dite					

STAFI I PROJEKTIT

STAFI I KRYESOR SHOQERIA "ERALD-G"

1	Gazim ISLAMI	Inxhinier Ndertimi	Planifikim/ Projektim per Objekte Civile, Rruge, Ura, Vepra Nentokesore, etj	Drejtues Ligjor & Teknik i Shoqerise Erald-G
2	Ilir KOKOMANI	Arkitekt	Planifikim/Projektim Urban dhe Arkitektonik	Drejtues Teknik i Shoqerise Erald-G
3	Hajdar KURTI	Inxhinier Elektrik	Planifikim/ Projektme elektrike	Drejtues Teknik i Shoqerise Erald-G
4	Leonard KAZANXIU	Inxhinier Gjeolog	Planifikim/Vleresim/Projekti m gjeologjik	Drejtues Teknik i Shoqerise Erald-G
5	Kujtim CANAMETI	Inxhinier Gjeodet	Vleresime mjedisore / Projektim gjeodezike	Drejtues Teknik i Shoqerise Erald-G
6	Ylber CANI	Inxhinier kimist	Vleresime mjedisore / Mbikqyrje ne mjedis	Drejtues Teknik i Shoqerise Erald-G
7	Luglano KOÇEKU	Ekspert	Menxhim i kontratave	I punesuar me Kontrate Pune (Erald-G)
8	Laurela KOÇEKU (ISLAMI)	Ekonomiste	Ekspert Ekonomi - Finance	E punesuar me Kontrate Pune (Erald-G)

STAF MBESHTETES

1	Ariela KUSHI	Arkitekthe/Urbaniste	Planifikim/Projektim Urban dhe Arkitektonik	I punesuar me Kontrate bashkepunimi (Erald-G)
2	Riza SHPATI	Inxhinier Hidroteknik	Projektim Ujesjelles Kanalizime, etj	I punesuar me Kontrate bashkepunimi (Erald-G)
3	Arben MUHA	Inxhinier Mekanik	Ekspert mjedisi /Vleresime te ndikimit ne mjedis	I punesuar me Kontrate Pune (Erald-G)

6. DOREZIMI I MATERIALEVE

Konsulentit në përfundim të projektit do dorëzojë dokumentacionin sipas listës në vijim:

- ✦ Relacioni i përgjithshëm i projektit. Format A4
- ✦ Projekti arkitektonik: Format A2, A1, A0
 - Planimetri
 - Pamje të gjendjes ekzistuese
 - Pamje të propozuara të projektit
 - Fotomontazhe.
 - Detaje Arkitektonike
 - Detaje Zbatimi
 - Relacionet dhe specifikimet përkatëse

Shenim Teknik :

Te gjitha Vizatimet Arkitektonike te jene ne

shkallen 1:100;

shkallen 1:200;

shkallen 1:500

- ✦ Preventivi i punimeve dhe analiza e tyre, sipas manualit të çmimeve në fuqi të miratuar nga Ministria, i shoqëruar me specifikimet teknike përkatëse, në Format A4.
- ✦ Grafiku i punimeve
- ✦ Vlerësim të ndikimit në mjedis

Projekti do të hartohet dhe paraqitet në 5 kopje, të printuara sipas formateve të specifikuara me sipër dhe informacioni tërësisht i dixhitalizuar (.dwg + .pdf) në 5 kopje


- (CD apo DVD)

- ✦ Kopja elektronike e projektit është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik të dorëzuar.
- ✦ Dorëzimi do të bëhet pranë Bashkisë Durrës
- ✦ Depozitimi i tij do të bëhet pranë Sekretarisë Teknike të Departamentit të Urbanistikës të Bashkisë Durrës.

SHOQËRIA "ERALD-G" sh.p.k.

Gëzim ISLAMI

Përfaqësuesi



OFERTA EKONOMIKE E DETAJUAR
OBJEKTI : STUDIM PROJEKTIM RIKUALIFIKIM I FASADAVE NË QYTET,
BASHKIA DURRËS

Nr.	Pershkrimi	Koha (muaj)	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë)
I. Tarifa sipas kategorise se punes (STAFI KRYESOR)					
1	Drejtuesi i Projektit/Arkitekt	1	1	85000	85,000
2	Inxhinier Urbanist /Arkitekt	1	1	85000	85,000
3	Inxhinier Ndertimi	1	1	85000	85,000
4	Inxhinier Topograf	1	1	85000	85,000
5	Inxhinier Elektrik	1	1	85000	85,000
6	Eksperti i Mjedisit / me çertifikate	1	1	85000	85,000
SHUMA I					510,000
II. Pagesa ditore (zyra)					
1	Ekspert te ndryshem	1	2	60000	120,000
2	Shofer	1	2	60000	120,000
3	Te ndryshme, prezantimet, takimet me publikun, etj	total	1	200000	200,000
SHUMA II					440,000
III. Kosto te drejperdrejta					
1	Makina transporti	1	4	122000	488,000
2	Printime, fotokopje, etj	1	1	600000	600,000
3	Raport final, prezantimi i projektit	1	1	200000	200,000
SHUMA III					1,288,000
IV. Te tjera					
1	shpenzime te rimbursueshme				-
SHUMA IV					-
TOTALI (I+II+III+IV)					2,238,000
TVSH		20%			447,600
TOTALI (me TVSH)					2,685,600

"ERALD-G" sh.p.k.

Gëzim ISLAMI
Përfaqësues




OFERTA EKONOMIKE

OBJEKTI : STUDIM PROJEKTIM RIKUALIFIKIM I FASADAVE NË QYTET,
BASHKIA DURRËS

1	Tarifat sipas Kategorisë së Punës	Lekë		510,000
2	Pagesat Ditore	Lekë		440,000
3	Kostot e Drejtpërdrejta	Lekë		1,288,000
4	Shpenzimet e rimbursueshme	Lekë		-
TOTALI PA TVSH				2,238,000
	TVSH 20%		20%	447,600
TOTALI ME TVSH				2,685,600

"ERALD-G" sh.p.k.

Gëzim ISLAMI
Përfaqësuesi



AUTORITETI KONTRAKTOR

Bashkia Durrës

Vangjush DAKO
Kryetar i Bashkisë

KONTRAKTUESI

"ERALD - G"

Gezim ISLAMI
Administrator i shoqërisë

